



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/37

Datë: 30.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (1), (2) dhe (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, dhe duke marrë parasysh Vendimet e Qeverisë Nr. 01/14 të datës 20 mars 2020 dhe Nr. 01/20 të datës 31 mars 2020, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 01/20 të datës 31 mars 2020 për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë

1. Në marrëdhëniet tregtare me Serbinë, ndalohen dokumentet për produktet bujqësore dhe industriale që:
 - 1.1. përdorin emra të vendeve ose përmbajnë elemente të tjera në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. përmbajnë emra të vendeve në Republikën e Kosovës, por nuk përmbajnë emrin e shtetit;
 - 1.3. i referohen Republikës së Kosovës përveçse me emrin Republika e Kosovës; ose
 - 1.4. përmbajnë çfarëdo elementi që mohon pavarësinë ose sovranitetin e Republikës së Kosovës ose trajton Republikën e Kosovës si të pabarabartë.
2. Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë të përdorë emrin dhe stemën e Republikës së Kosovës në certifikatat fitosanitare dhe veterinare.
3. Operatorët ekonomikë nga Serbia duhet të pajisen me leje hyrëse për secilin automjet me mallra që hyn në Republikën e Kosovës. Kërkesa për leje hyrëse i paraqitet zyrës ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Serbi me letër ose përmes postës elektronike.
4. Nuk mund të njihet si person juridik një shoqëri tregtare e themeluar sipas rregullave të autoriteteve në Serbi. Pa marrë parasysh formën e organizimit të saj në Serbi, një shoqëri e tillë mund të njihet, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, si:
 - 4.1. biznes individual i personit fizik që kontrollon shoqërinë, kur ka një person të tillë; ose
 - 4.2. ortakëri e përgjithshme e personave fizikë që kontrollojnë shoqërinë, kur ka disa persona të tillë.

5. Obligohen ta zbatojnë këtë vendim:

- 5.1. Ministria e Financave dhe Transfereve;
- 5.2. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike;
- 5.3. Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike;
- 5.4. Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë;
- 5.5. Dogana;
- 5.6. Policia;
- 5.7. Inspektorati i Tregut;
- 5.8. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve dhe
- 5.9. institucionet e tjera përgjegjëse.

6. Ndryshohet, plotësohet dhe mbetet në fuqi për afat të pacaktuar Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/20 i datës 31 mars 2020.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Më 31 mars 2020, Qeveria e Republikës e Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr. 01/20 për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë. Masat e reciprocitetit ose veprimet të ndërsjellë janë institut i marrëdhënieve mes shteteve sovraane, i njohur nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe nga Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT) e vitit 1947, e ndryshuar më 1994.

Vendimi i Qeverisë Nr. 01/20 ka synuar mënjanimin e barrierave tregtare jotarifore që autoritetet në Serbi kanë vendosur ndaj Republikës së Kosovës, duke përfshirë barrierat në transit, barrierat teknike dhe barrierat politike. Pika 3. e Vendimit Nr. 01/20 ka paraparë rishikimin e kohëpaskohshëm të zbatimit dhe përshtatshmërisë së masave të reciprocitetit.

Një grup ndërinstitucional, i ftuar nga Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, ka vëzhguar zbatimin e masave dhe ka identifikuar barrierat e vazhdueshme dhe të reja në marrëdhëniet tregtare me Serbinë. Grupi ndërinstitucional ka dorëzuar një raport vlerësues më 28 maj 2020, në të cilin i ka rekomanduar Qeverisë këto masa:

- të lërë në fuqi Vendimin Nr. 01/20 ose ta shfuqizojë me supozimin se masat nga vendimi janë detyrim i qartë ligjor për institucionet dhe se institucionet duhet të vazhdojnë t'i zbatojnë ato;
- të obligoj Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të përdorë emrin e shtetit në certifikatat fitosanitare dhe veterinare;
- të obligoj Doganën që në marrëdhëniet tregtare me Serbinë të mos pranojë dokumente të cilat: (i) i referohet Republikës së Kosovës me kodin "XK"; (ii) përmendin emrin e qytetit në Republikën e Kosovës, por nuk përmendin emrin e shtetit; dhe (iii) përdorin kombinime të pabarabarta të emrave të shteteve, si p.sh. "Republika Srbija" në një të anë dhe "Kosovo" pa cilësimin *Republikë* në anën tjetër; dhe
- të sigurojë se Inspektorati i Tregut do të largojë nga tregu produktet e Serbisë që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u kushtuar vëmendje të veçantë shenjave kombëtare të konformitetit.

Grupi ndërinstitucional ka identifikuar tutje barrierën që autoritetet në Serbi kanë vendosur ndaj transportit të mallrave, duke u kërkuar operatorëve ekonomikë nga Republika e Kosovës që të pajisen me leje hyrëse nga zyra ndërlidhëse në Prishtinë para se të hyjnë në territorin e Serbisë.

Krahas gjetjeve të grupit ndërinstitucional, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike ka vërejtur se autoritetet në Serbi nuk njohin personalitetin juridik të shoqërive tregtare të themeluara sipas ligjeve të Republikën e Kosovës.

Qeveria konstaton se barrierat e Serbisë po vazhdojnë të dëmtojnë eksportuesit dhe importuesit nga Republika e Kosovës dhe të shkaktojnë deficit tregtar për Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, duke u mbështetur në parimet dhe arsyet e lartëcekura, Qeveria vendosi të plotësojë si në dispozitiv masat e reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretariatit të CEFTA-s
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/37

Datë: 30.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore Kompania Rajonale e Ujësjetës "Gjakova" Sh. A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i ndërmarrjes nga pika 1. e këtij vendimi në këtë përbërje:
 - 2.1. Z. Robert Lekaj, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. Z. Luan Matoshi, drejtor;
 - 2.3. Znj. Miranda Zherka, drejtore; dhe
 - 2.4. Z. Urim Gashi, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	30.5.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre në detyrë, MEPTINIS
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues i propozim-vendimit për shkarkim-emërimin e bordit të KRU “Gjakova” ShA

I nderuar z. Kryeministër Kurti,
i nderuar z. Zëvendëskryeministër Abazi,
të nderuar kolegë ministra e ministre:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë së Republikës së Kosovës të shkarkojë bordin e drejtorëve dhe të emërojë një bord të përkohshëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës “Gjakova” ShA. Qeveria duhet t’i shkarkojë drejtorët, sepse ka arsye të besojë se ata kanë shkelur detyrat që u janë besuar, duke lejuar keqpërdorimin e pronës dhe dëmtimin e mjedisit.

KRU Gjakova ka ndërtuar pa leje një hotel afër liqenit të ujit të pijes, në zonë të mbrojtur, ku ndalohen objektet turistike e rekreative. Hoteli është ngritur në pronën e ndërmarrjes dhe me mjetet e ndërmarrjes, por pas hapjes i është dhënë në shfrytëzim një operatori privat. Bordi i emëruar më 2015 ka qenë në detyrë nga fillimi në përfundim të ndërtimit, ka miratuar planifikimin biznesor dhe buxhetor që përfshin ndërtimin, andaj është drejtpërdrejt përgjegjës për këtë shkelje të shumëfishtë.

1. Faktet

Ujësjetësi rajonal i Gjakovës ka zanafillën në hidrosistemin “Radoniq”, një projekt dhe subjekt juridik për furnizim me ujë të pijes dhe ujitjes, i nisur në fundvitet 1970. Pjesë e projektit ka qenë ndërtimi i rezervuarit artificial, që njihet si liqeni i Radoniqit ose Dukagjinit. Penda është ngritur dhe rezervuari ka nisur të mbushet me ujë më 1983.

Atë vit, sekretariati i urbanizmit i komunës së Gjakovës ka nxjerrë aktvendim, me të cilin i ka dhënë hidrosistemit “Radoniq” leje ndërtimi për një objekt të rojës së digës.¹

¹ Provë: shtojca 1.

Sipas një skice të kohës, leja është dhënë për P+1+NK: përdhesë, një kat dhe nënkulm.² Asetet e hidrosistemit i ka trashëguar kompania rajonale e ujësjellësit, që është themeluar si ndërmarrje publike më 2007 me emrin KRU "Radoniqi" dhe ri-emërtuar më 2017 si KRU "Gjakova".

Më 2013, duke u thirrur në Ligjin për ujërat, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin 09/127 për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masat e tyre mbrojtëse të burimit ujqor sipërfaqësor – Akumulimi i Radoniqit.³ Vendimi cakton tri zona të mbrojtura përreth liqenit: e para 10 metra nga uji, kurse e dyta në 200 metrat vijuese.⁴ Në zonën e dytë ndalohet "ndërtimi i objekteve për turizëm ose rekreacion dhe objekteve tjera të cilat mund të rrezikojnë cilësinë e ujit".⁵ Objekti i rojës së digës ndodhet në zonën e dytë.⁶

Objekti është dëmtuar dhe amortizuar rëndë përgjatë tri dekadave, e veçanërisht gjatë luftës më 1999. Kështu që në prill 2015, ndërmarrja ka kërkuar leje për të ndërtuar një objekt të ri mbi themelet e vjetra. Kërkesën për "per dhenjen e pelqimit per ndertimin e objektit te Rojeve ne Dige ne themelet ekzistuese[sic]" e ka dorëzuar në drejtorinë e urbanizmit të komunës kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes, duke i bashkëngjitur certifikatën e pronësisë, lejen e vitit 1983 dhe fotot e objektit të vjetër njëkatësh.⁷

Drejtoria e urbanizmit e komunës ka refuzuar kërkesën e ndërmarrjes për mungesë të dokumentacionit, me konkluzionin e 27 majit 2015.⁸

Por ndërmarrja ka filluar punimet. Dhe ndërtesa e paralajmëruar si objekt administrativ është ngritur si objekt hotelier. Ky ridestitim ka tërhequr vëmendjen e kryetares së komunës, që në tetor 2016 u ka kërkuar informata për ligjshmërinë e ndërtimit kryeshefit të ndërmarrjes, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).⁹

Në përgjigjen e tij, kryeshefi ka cekur se ndërtimi është pjesë e projektit madhor "Ekzekutimi i Fazës së Dytë të përpunimit të Ujit të Pijes, linjës së ujit – Anadrini dhe kanali derivues i Bazenit Radoniqi[sic]", duke shtuar se ndërtimi ka vijuar me mjete vetanake të ndërmarrjes sipas lejes së vitit 1983 dhe se për këtë është njoftuar komuna. Kryeshefi madje ka siguruar kryetaren e komunës se janë marrë masa për të mbrojtur mjedisin, se "Objekti Administrativ" ndodhet 120 metra larg liqenit, se do të shërbejë për veprimtaritë e ndërmarrjes dhe se "nuk ka destinacione tjera".¹⁰ Sekretari i MZhE-së i ka hedhur përgjegjësinë për ndërtimin ndërmarrjes.¹¹ Në një shkresë

2 Provë: shtojca 2.

3 Vendim 09/127 i Qeverisë, 24.4.2013.

4 Po aty, nenet 10.1 dhe 11.1.

5 Po aty, neni 11.4.3.

6 Prova: shtojca 3 dhe 4.

7 Provë: shtojca 5.

8 Provë: shtojca 6.

9 Provë: shtojca 7.

10 Provë: shtojca 8.

11 Provë: shtojca 9.

pa datë, Departamenti i Ujërave i MMPH-së ka cilësuar të paligjshëm ndërtimin në zonat e mbrojtura përreth liqenit.¹²

Punimet nuk janë ndalur gjatë gjithë 2016-tës e 2017-tës. Në nëntor 2016, inspektorati komunal ka konstatuar se objekti i ri është ngritur pa leje rindërtimi dhe ka tejkaluar dukshëm përmasat e ngrehinës së vjetër: "në ngastren 0888/1 në vendin ku ka qenë objekti ekzistues me dim: 12,77x20,0m P+1+N është ngritur objekti me dim: 14x17,0m ku në pjesën veriore ka etazhitet P+2 me dim:17,0x6,0m kurse atë jugore P+2+N. Gjerë më tani nuk janë pajisur me leje për rindërtim të objektit nga organi kompetent."¹³

Në maj 2017, MMPH ka dhënë një pëlqim për shfrytëzimin e objektit administrativ, por ka shtuar se duhet siguruar leja e ndërtimit.¹⁴ MMPH madje thekson se pëlqimi nuk mund t'i bartet një pale të tretë dhe se ndërmarrja duhet të kërkojë miratim të ri nëse objekti do të shfrytëzohet për qëllime të tjera.¹⁵

Ndërmarrja nuk ka siguruar lejen ndërtimore, për të cilën e ka udhëzuar MMPH. Në dhjetor 2017, roja përreth objektit nuk ka lënë inspektorët komunalë të hyjnë brenda pa "autorizimin nga ana e shefit të ekzekutivit të K.R.U. 'Gjakova', sepse nuk ka kompetenca askush që ti afrohet objektit."¹⁶

Në pranverën 2018, ndërtimi veç ka përfunduar. Në adresë të ish-kryetares dhe kryetarit të ri të komunës kanë arritur ftesa për ceremoninë e përvënimit të hotelit "Liqeni i Dukagjinit".¹⁷ Më 16 qershor 2018, ceremonia është mbajtur me praninë e kryetarit.¹⁸ Ish-kryetarja, tani deputete, ka ngritur çështjen e hotelit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.¹⁹

Bordi i drejtorëve i ndërmarrjes është emëruar me vendim të Qeverisë më 24 tetor 2015.²⁰ Mandati 3-vjeçar tashmë i ka skaduar, por bordi po vijon në detyrë, meqë nuk është përzgjedhur ende një bordi ri.

2. Shkarkimi i bordit

Qeverisja e ndërmarrjeve publike

Neni 119.9 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë:

Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimizojë vlerën afatgjatë të ndërmarrjes.

12 Provë: shtojca 10.

13 Provë: shtojca 11.

14 Provë: shtojca 12, pika 2.4.

15 Po aty, pikat 3 dhe 4.

16 Provë: shtojcat 11 dhe 13.

17 Provë: shtojca 14.

18 Provë: shtojca 15.

19 Prova: shtojcat 16 dhe 17.

20 Vendim 05/54 i Qeverisë, 24.10.2015.

Tutje, Ligji për ndërmarrjet publike (LNP) përcakton se si ushtrohet e drejta e pronësisë.²¹ Neni 5.1 saktëson:

Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në NP-të Qendrore. Qeveria do të vendos mbi këto çështje me shumicë të thjeshtë votash.

Të gjitha ndërmarrjet publike organizohen si shoqëri aksionare.²² Ligji për shoqëritë tregtare vlen për aq sa Ligji për ndërmarrjet publike nuk ka përcaktuar rregulla të posaçme.²³

Ministria përgjegjëse për zhvillimin ekonomik ndihmon Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të aksionarit.²⁴ Në kuadër të ministrisë vepron Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (Njësia ose NjPMNP).²⁵

Detyrat fiduciare

Drejtorët në bord kanë ndaj ndërmarrjes dhe aksionarit një varg detyrash fiduciare apo të besuara. Termi *detyrë fiduciare*, i huazuar nga anglishtja, përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.²⁶ Detyrat fiduciare përkojnë me standardet etike të parapara me Kodin e etikës dhe të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve publike, që përfshijnë veprimin në interesin më të mirë të ndërmarrjes, angazhimin “për të siguruar pajtueshmëri me ligjet në fuqi” dhe raportimin e shkeljeve.²⁷

Bordi i drejtorëve gjithashtu ka detyrë të mbikëqyrë punën e zyrtarëve të lartë, t’u kërkojë raporte kur nuk përmbushin caqet, dhe madje të shqyrtojë shkarkimin dhe zëvendësimin e tyre.²⁸ Zyrtarët mund të shkarkohen kur devijojnë nga caqet që ka caktuar bordi,²⁹ por duhet të shkarkohen kur shkelin detyrat fiduciare.³⁰

Ligji për shoqëritë tregtare njih ndërkompentencat e bordit “miratimi[n e] planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike” si dhe tagrin shtesë që i jepet bordit me statut të shoqërisë aksionare.³¹ Statuti i ndërmarrjes detyron bordin, ndër të tjera, të:

2.2.1. Respektoj statutin e kompanisë dhe aktet ligjore dhe të zbatoj vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, në pajtueshmëri me ligjin;

21 Ligj 03/L-087 për ndërmarrjet publike (LNP), GZRK 31/08, 15.6.2008, ndryshuar me Ligjin 04/L-111, GZRK 13/12, 30.5.2012 (fuqi 15.6.2012), Ligjin 05/L-009, GZRK 10/15, 7.5.2015, dhe Ligjin 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, GZRK 3/18, 19.4.2018 (fuqi 4.5.2018).

22 LNP, neni 4.1.

23 Ligj 06/L-016 për shoqëritë tregtare (LShT), GZRK 9/2018.

24 LNP, nenet 5.1 dhe 37.1; Rregullore QKR 05/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, shtojca 7 e rregullores, pikat 6-7.

25 LNP, neni 37.1.

26 Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black’s Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

27 Kodi i etikës dhe qeverisjes korporative për ndërmarrjet publike, MZHE, ribot. 2014, para. 16.4, pikat (b), (g) dhe (h).

28 LNP, nenet 18 dhe 23.

29 LNP, neni 18.3.

30 LNP, neni 23.2.

31 LShT, neni 162, para. 1.1 dhe 1.12.

- 2.2.2. Përcaktoj, dhe rregullisht – së paku çdo tre muaj – të rishikoj strategjinë e kompanisë;
 - 2.2.3. Përgatisë dhe miratoj strategjinë afatgjatë, investimet dhe planet financiare të kompanisë dhe – brenda afatit relevant kohor – të rishikoj atë kurdo që është e nevojshme, së paku çdo tre muaj, të bëj ndryshime të cilat mund të jenë të nevojshme;
 - 2.2.4. Ne bazë të këtyre planeve afatgjate, nxjerr direktiva strategjike për KSHE kurdo që është e nevojshme;
 - 2.2.5. Miratoje planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor të përgatitur nga KSHE në bazë të planit të tillë afatgjatë;
- [...]³²

Të gjitha këto detyrime janë detyrime fiduciare.

Rregullimi i ujërave dhe ndërtimit

Ligji i sotëm për ujërat ka hyrë në fuqi më 2013, duke zëvendësuar ligjin e 2004-tës.³³ Të dy ligjet autorizojnë Qeverinë dhe ministrinë përgjegjëse të nxjerrin akte për zona të mbrojtura përreth burimeve ujore.³⁴ Mbështetur në këtë autorizim, MMPH ka nxjerrë udhëzimet administrative për kriteret e zonave të mbrojtura.³⁵ Kurse Qeveria ka marrë vendimin për zonat e mbrojtura ujore përreth liqenit të Dukagjinit.³⁶

Ngjashëm, Ligji për ndërtim është në fuqi nga viti 2012.³⁷ Neni 14.1 përcakton “Llojet për të cilat lëshohet leja ndërtimore” si vijon:

Leja ndërtimore kërkohet për aktivitetet vijuese:

- 1.1. ndërtimi i ri (përfshirë montazhet);
- 1.2. rindërtimi i objekteve ekzistuese;
- 1.3. rrënimi i objekteve ekzistuese, dhe
- 1.4. riparimi i objektit ndërtimor, nëse ndodh ndryshim thelbësor i tij krahasuar me situatën para paraqitjes së dëmit nga katastrofat natyrore, luftërat apo ngjarjet e ngjashme.
- 1.5. intervenimet në fasadat dhe strukturën (sanimet) e një objekti ekzistues.

Ligji përkufizon në hollësi domethënien e termave rindërtim dhe riparim.³⁸ Pa marrë parasysh llojin e aktivitetit ndërtues, është e qartë se kërkohet leje ndërtimore për kur rindërtohet objekti ose kur ndryshohet thelbësisht gjendja e objektit.

32 Statuti i KRU “Radoniqi” ShA, 2009, botuar në sajtin e ndërmarrjes, neni 14.2.

33 Ligj 04/L-147 për ujërat e Kosovës, GZRK 10/2013; Ligj 2004/24 për ujërat e Kosovës, GZK 18/2007, shfuqizuar.

34 Ligj 04/L-147, neni 66; ligj 2004/24, neni 52.

35 UA MMPH 15/2017 për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare të burimeve të ujit, GZRK 29.12.2017; UA MMPH 28/2014 për zonat e mbrojtura sanitare, GZRK 30.12.2014.

36 Vendim 09/127 i Qeverisë, 24.4.2013.

37 Ligj 04/L-110 për ndërtim, GZRK 18/2012.

38 Po aty, nenet 3.1.5 dhe 3.1.11.

Lejet ndërtimore janë parimisht tagër i komunës. Përjashtim bëjnë disa ndërtime të mëdha të rëndësishme shtetërore, për të cilat përgjigjet niveli qendror.³⁹

Baza juridike për shkarkim

Neni 19.3 LNP përcakton detyrimin e Qeverisë për të shkarkuar drejtorin për të cilin besohet se ka shkelur detyrat:

Nëse Aksionari(ët) kanë arsye për të besuar se ka mundësi që një drejtor të ketë bërë shkeljen e detyrave fiduciare, ata menjëherë do ta shkarkojnë dhe zëvendësojnë drejtorin ose drejtorët të cilët me arsye besohet se kanë bërë shkeljen e detyrave të tyre fiduciare, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që mund të paraqesë për NP-në ngritja e një padie nga ana e drejtorit/ëve të shkarkuar.

Sipas rregullores për fushat e përgjegjësisë administrative, Qeveria vendos për emërimet dhe shkarkimet të cilat i ngarkohen me ligj.⁴⁰

Shkeljet në KRU Gjakova

KRU Gjakova është ndërmarrje publike qendrore, në pronësi të Republikës së Kosovës. Ministria e Ekonomisë, Punësimi, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike është në të drejtën e saj t'i propozojë Qeverisë vendime lidhur me KRU Gjakovën.⁴¹

Siç e kemi cekur tashmë, bordi i drejtorëve ka detyrë fiduciare të sigurojë se ndërmarrja vepron në përputhje me ligjet në fuqi. Kemi vënë re se ligji dhe aktet e mbështetura në ligj ndalojnë ndërtimin e objekteve turistike e rekreative në zonat e mbrojtura përreth liqenit Dukagjini-Radoniqi. Njëherësh, ligji kërkon leje për rindërtim ose renovim të objekteve të dëmtuara nga lufta.

Në rastin tonë, KRU Gjakova ka ndërtuar një objekt të ri, me madhësi, pamje e destinim të ndryshëm nga objekti i dikurshëm i rojës së digës, i ngritur në vitet '80 dhe i dëmtuar gjatë luftës. Komuna nuk ka dhënë leje ndërtimi, rindërtimi ose renovimi. Tutje, siç pranon vetë kryeshefi i ndërmarrjes, objekti ndodhet 120 metra larg ujit, që i bie se është brenda zonës së dytë të mbrojtur prej 200 metrave pas zonës së parë. Objekti tani është inauguruar si hotel, çka e bën atë objekt turistik-rekreativ, të ndaluar me vendimin e qeverisë për zonat e mbrojtura.

Ndonëse MMPH ka dhënë një pëlqim për shfrytëzimin e objektit administrativ, ajo i ka kërkuar ndërmarrjes të pajiset me lejen e munguar ndërtimore, meqë leja e vitit 1983 është dhënë për objekt më të vogël dhe nuk mjafton. MMPH ka saktësuar gjithashtu se pëlqimi s'mund të bartet dhe se ndërmarrja duhet të kërkojë miratim para se të shfrytëzojë objektin për qëllime të reja. Kësisoj, pëlqimi i MMPH-së nuk abstra-

39 Po aty, nenet 15 e 19 dhe shtojca 1 e ligjit.

40 Rregullore 05/2020, neni 4.2.4.

41 Rregullore 05/2020, shtojca 7 e rregullores, pikat 6-7.

hon shkeljet e ndërmarrjes – mungesën e lejes ndërtimore, ridestinimin e objektit dhe bartjen e posedimit.

Godina e ngritur në tokën e ndërmarrjes publike, në zonën ku ndalohen objektet turistike-rekreative, shfrytëzohet sot si hotel nga një kompani private.

Të gjitha këto shkelje kanë ndodhur në sytë dhe me bekimin e bordit të drejtorëve, i cili është emëruar më 2015 dhe vijon në detyrë. Bordi ka miratuar planin e biznesit dhe buxhetin që është investuar në objektin hotelier. Në teori, bordi ka mbikëqyrur rreptë punën e menaxhmentit gjatë këtyre viteve, dhe nuk i ka shpëtuar investimi madhor në hotelin “Liqeni i Dukagjinit”.

Në këto rrethana, Qeveria ka arsye të bazuara për të besuar se bordi i drejtorëve i KRU Gjakovës ka shkelur detyrat fiduciare, duke lejuar ndërtim pa leje dhe në zonë të mbrojtur, duke lejuar tjetërsimin e pronës së ndërmarrjes dhe duke rrezikuar mjedisin dhe cilësinë e ujit që u shërbehet qytetarëve. Për këto arsye, Qeveria duhet t’i shkarkojë drejtorët e ndërmarrjes, sipas nenit 19.3 LNP.

3. Emërimi i bordit të përkohshëm

Baza juridike për emërimin

Neni 43 i Ligjit për ndërmarrjet publike, i ndryshuar dhe plotësuar, parasheh emërimin e një bordi të përkohshëm si vijon:

43.1 Qeveria është e autorizuar që ta emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve (“Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve”) për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar me miratimin e Vendimit mbi Themelimin e një Ndërmarrje Publike të re apo nga shkarkimi i bordit aktual deri në përzgjedhjen e bordit të përhershëm në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.⁴²

43.2 Qeveria do ta ushtrojë këtë autoritet sa më shpejtë që të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

43.3 Secili Bord i Përkohshëm i Drejtorëve do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe duhet të përfshijë KE-në ose menaxherin e lartë të NP-së. Gjatë emërimit të drejtorëve të tjerë të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve, Qeveria do të bëjë përpjekje maksimale për të siguruar që këta drejtorë t’i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 17 të këtij ligji.

43.4 Mandati i secilit Bord të Përkohshëm të Drejtorëve do të skadojë, cilado që ndodh më herët (i) mesnatën e ditës e cila rastis gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji ose (ii) ditën në të cilën zgjidhet

42 Ndryshuar më 2012 me ligjin 04/L-111, neni 22.

bordi i plotë i drejtorëve për NP-në përkatëse në përputhje me nenin 15 ose 16 të këtij ligji.

43.5 Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. Pas skadimit të mandatit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, ky bord dhe drejtorët e tij pushojnë të kenë çfarëdo autorizimi të çfarëdo përshkrimi për të vepruar në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së.

Deri në zgjedhjen e bordit të ri, pra, Qeveria duhet që sa më shpejt të emërojë një bord të përkohshëm, i cili shërben më së gjati 6 muaj.⁴³ Bordi i përkohshëm ka 5 drejtorë – Qeveria emëron 4, kurse kryeshefi shërben si drejtori i pestë. Ndonëse nuk lypset konkurs, sa është e mundshme, duhet emëruar kandidatë që plotësojnë kushtet dhe cilësimet e përcaktuara në paragrafët 1 e 4 të nenin 17, për drejtorët me mandat të plotë.⁴⁴

Neni 19 detyron Qeverinë të shkarkojë bordin “menjëherë” kur lindin shkaqet e shkarkimit, kurse neni 43 kërkon që Qeveria të emërojë bord të përkohshëm “sa më shpejt”. Këto kërkesa natyrisht pamundësojnë konkursin, që merr muaj vetëm për të mbledhur aplikimet e kandidatëve. Madje – për shkak se emërimit duhet t’i paraprijë shkarkimi i një bordi që ka shkelë detyrat dhe rrezikon ta dëmtojë ndërmarrjen – Qeverisë i duhet diskrecion për të identifikuar kandidatët shpejt e pa ndërhyrje nga jashtë.

Kandidatët e propozuar

Kandidatët e nominuar në propozim-vendim janë ekspertë të sektorit në të cilin vep-ron ndërmarrja dhe ekspertë të qeverisjes së ndërmarrjeve, me përvojë të dëshmuar.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve do të ketë këtë përbërje:

- z. Robert Lekaj, kryesues dhe drejtor;
- z. Luan Matoshi, drejtor;
- znj. Miranda Zherka, drejtor; dhe
- z. Urim Gashi, drejtor.

CV-të e kandidatëve i janë bashkëngjitur si shtojcë këtij memorandum. ⁴⁵

43 LNP, neni 43.

44 LNP, neni 43.3. Paragrafi 1 i nenit 17 thotë se duhet plotësuar edhe kërkesat e paragrafëve 2 e 3. Por neni 43.3 përjashton këta dy paragrafë duke përmendur vetëm “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 17 të këtij ligji”. Ky formulim pra nuk përfshin kërkesat e përcaktuara në paragrafë të tjerë. Për dallim, në dispozita të tjera hasim formulime si “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17” (neni 15.4), “kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17” (neni 16.5), “kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni” (neni 17.5), dhe “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-4 të nenit 17” (neni 20.3). Përjashtimin e paragrafëve 2 dhe 3 e nenit 17 e mbështet edhe detyrimi i Qeverisë për të vepruar shpejt.

45 Provë: shtojca 18.

Bordi me mandat të plotë

Në ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit nis procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve me mandat të plotë, sipas ligjit.⁴⁶ Sekretari emëron një komision rekomandues të përbërë nga shërbyes civilë me cilësimet e caktuara në ligj.⁴⁷ Gjithashtu cakton dhe zbaton rregullat e punës së komisionit, që përfshijnë ndalimin e konfliktit të interesit dhe metodologjinë e vlerësimit.⁴⁸ Komisioni pastaj identifikon dhe ia propozon Qeverisë kandidatët për bordin e ri.⁴⁹ Ecuria e përzgjedhjes së drejtorëve duhet të jetë e hapur dhe e paanshme.⁵⁰

* * *

Si përfundim, për arsyet e sipërcekura, i propozoj Qeverisë që të miratojë propozim-vendimin për shkarkimin e bordit të tanishëm dhe emërimin e një bordi të përkohshëm të KRU Gjakovës.

Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë

Shtojca (18):

1. Aktvendim i Sekretariatit të Urbanizmit të Komunës së Gjakovës, 05 nr. 351 50, 5.2.1983, 2 f.
2. Skicë e planit të objektit P+1+NK, pa datë, 1 f.
3. Hartë e ngastrave përreth liqenit, nga Geoportali i Republikës së Kosovës, 1 f.
4. Hartë e liqenit dhe zonave të mbrojtjes, 1 f.
5. Kërkesë e kryeshefit Ismet Ahmeti në emër të KRU Radoniqit, drejtuar drejtorisë së urbanizmit të Komunës së Gjakovës, "Kerkese per dhenjen e pelqimit per ndertimin e objektit te Rojeve ne Dige ne themelet, ekzistuese[sic]", 3.4.2015, me bashkëngjitjet, 9 f.
6. Konkluzion i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-25458, 27.5.2015, me foto të bashkëngjitur, 2 f.
7. Mesazh me postel nga kryetarja e Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila, drejtuar kryeshefit Ismet Ahmeti dhe të tjerëve, "Leja e Ndertimit per Objektivin Administrativ/Hotelier ne afersi te liqenit te Radoniqit", 27.10.2016, 2 f.

46 LNP, neni 15, para. 1-2 dhe 5.

47 LNP, neni 15.2.

48 LNP, neni 15.3.

49 LNP, neni 15.2.

50 LNP, neni 15.5.

8. Mesazh me postel nga kryeshefi Ismet Ahmeti, drejtuar kryetares së Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila, "Re: Leja e Ndertimit per Objektiv Administrativ/Hotelier ne afersi te liqenit te Radoniqit", 28.10.2016, me shkresën e bashkëngjitur dhe mesazhin fillestar të kryetares, 4 f.
9. Mesazh me postel nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Nazmi Zenelaj, drejtuar kryetares së Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila, "RE: Leja e Ndertimit per Objektiv Administrativ/Hotelier ne afersi te liqenit të Radoniqit", 27.10.2016, në përgjigje të mesazhit fillestar të kryetares, 3 f.
10. Mendim juridik i Departamentit të Ujërave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pa datë, 2 f.
11. Mesazh nënshkruar nga Hana, drejtuar ish-kryetares së Komunës së Gjakovës Mimoza Kusari-Lila, njoftim për inspektimin e kryer, 1.12.2017, 1 f.
12. Pëlqim për shfrytëzimin e objektit administrativ afër digës në liqenin e Radoniqit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 1945/17, 2.5.2017, 4 f.
13. Procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Gjakovës, nr. 354, 1.12.2017, foto nga vendi të bashkëngjitura, 5 f.
14. Ftesë për ceremoninë e përrurimit e hotelit "Liqeni i Dukagjinit", 1 f.
15. Pamje e ceremonisë së përrurimit të hotelit "Liqeni i Dukagjinit", 16.6.2018, 1 f.
16. Pyetje parlamentare të deputetes Mimoza Kusari-Lila, parashtruar ministrave të Zhvillimit Ekonomik dhe Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 1 f.
17. Transkript i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 5, 6, 9, 12, 19 dhe 23 korrik 2018, fq. 4-6, 3 f.
18. CV-të e kandidatëve për bordin e përkohshëm të drejtorëve, 14 f.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/37

Datë: 30.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e një Drejtori në Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc", Sh. A.

1. Z. Shpend Gjogja, emërohet Drejtor në Bordin e Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc", Sh. A.
2. Emërimi nga pika 1. e këtij vendimi ndryshon dhe plotëson pikën 2.4 të vendimit të Qeverisë Nr. 02/26 i datës 23 prill 2020.

A R S Y E T I M

Për të plotësuar pozitën e zbrazët në bordin e përkohshëm të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Hidroekonomike "Ibër Lepenc", Sh. A. Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi si në dispozitiv.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/37

Datë: 30.05.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, nenit 36, paragrafi 2, të Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF-Shpenzimi i Parave Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa Nr. 018/2020, e datës 29.04.2020 e Lotarisë së Kosovës Sh. A., për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej njëqindpesëdhjetenjë mijë e dyqindnëntëdhjetenëntë euro dhe nëntëdhjetepesë cent (151,299.95 €) për pagesën e obligimeve ndaj pagave bruto si dhe kontributit pensional të punëdhënësit për punonjësit e Lotarisë së Kosovës Sh. A., sipas listës në Shtojcën Nr. 1. të këtij vendimi, për periudhën që nga koha e ndalimit të aktivitetit sipas Ligjit Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit e deri më 30 prill 2020.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave dhe Transfereve, me kod 201, nën-programi Kontigjencat në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Ministrinë e Financave dhe Transfereve (me kod 201), nën-programi Thesari i Kosovës me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfereve (11202).
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi, përkatësisht: vlera neto prej njëqindnjëzetekatër mijë e shtatëqindnjëzetënjë euro dhe katërmëdhjetë cent (124,721.14 €) për pagesë transferohet si pagesë masive direkt përfituesve në numrat e llogarive në bazë të listës së Shtojcës Nr. 1. që është pjesë e këtij vendimi, kurse obligimet ndaj tatimit në vlerë prej dymbëdhjetë mijë e njëqindëgjashtëdhjetenëntë euro dhe njëzetnëntë cent (12,169.29 €) dhe kontributeve pensionale në vlerë prej katërmëdhjetë mijë e katërqindnëntë euro dhe pesëdhjetedy cent (14,409.52 €) transferohen në llogarinë e përcaktuar në Administratën Tatimore, përkatësisht Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në bazë të deklarimeve të Lotarisë së Kosovës Sh. A.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e vendimit, dhe obligohet Thesari i Kosovës të bëjë alokimin dhe ekzekutimin e pagesave sipas pikës 2 dhe 3 si dhe shtojcës bashkëngjitur si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve në emër të Qeverisë që mjetet e dhëna nga pika 1. e këtij vendimi t'i trajtojë në përputhje me statusin e ardhshëm ligjor të Lotarisë së Kosovës, si kapital aksionar të Qeverisë apo si subvencionim, në pajtim me vendimin e Qeverisë Nr. 19/111 të datës 19.07.2019.

6. Obligohen organet drejtuese të Lotarisë së Kosovës Sh. A. që të ndërmarrin veprimet e nevojshme që të mos krijohen obligime shtesë financiare nga data e marrjes së këtij vendimi dhe deri në zgjidhjen e statusit të këtij institucioni, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca Nr. 1

Nr.	Nr. Xhirologarisë	Te paguara dhe deklaruar në ATK					Obligimet ndaj pagave te papaguara				
		Bruto pagat e kalkuluar korrik 2019 deri prill 2020	Bruto pagat e paguara-deklaruar në ATK	Kontributi i punëdhënësit	Kontributi i punëtorit	Tatimi në paga i deklaruar	Bruto Pagat e papaguara	Kontributi i punëdhënësit	Kontributi i punëtorit	Tatimi në paga i papaguar	Paga neto për pagesë
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1300003001379423	9,676.00	2,529.57	126.48	126.48	113.07	7,146.43	357.32	357.32	656.71	6,132.40
2	1300003001327819	6,759.50	1,682.98	84.15	84.15	49.84	5,076.52	253.83	253.83	460.07	4,362.62
3	2014000001958611	6,032.80	1,420.87	71.04	71.04	34.81	4,611.93	230.60	230.60	415.93	3,965.40
4	1501001011616812	5,386.24	1,682.98	84.15	84.15	49.84	3,703.26	185.16	185.16	329.61	3,188.49
5	2011000021272916	5,479.60	1,292.54	64.63	64.63	29.9	4,187.06	209.35	209.35	375.57	3,602.14
6	1507030000501654	5,354.80	1,292.54	64.63	64.63	29.9	4,062.26	203.11	203.11	363.72	3,495.43
7	1110236761000126	2,864.64	1,090.80	54.54	54.54	0	1,773.84	88.69	88.69	0	1,685.15
8	1183004364000145	4,521.50	1,035.98	51.80	51.80	20.18	3,485.52	174.28	174.28	308.92	3,002.32
9	1700100100728357	4,093.20	908.24	45.41	45.41	15.33	3,184.96	159.25	159.25	280.37	2,745.34
10	1110313176000111	6,235.40	1,550.06	77.50	77.50	40.53	4,685.34	234.27	234.27	422.91	4,028.16
11	2020000044601742	5,594.00	1,420.87	71.04	71.04	34.81	4,173.13	208.66	208.66	374.25	3,590.22
12	1300003012135656	3,935.20	950.47	47.52	47.52	16.93	2,984.73	149.24	149.24	261.35	2,574.14
13	1300003005895452	4,882.30	1,248.67	62.43	62.43	28.24	3,633.63	181.68	181.68	323	3,128.95
14	2011000040289669	5,230.00	1,313.59	65.68	65.68	30.71	3,916.41	195.82	195.82	349.86	3,370.73
15	1701003032637993	5,230.00	1,459.19	72.96	72.96	36.23	3,770.81	188.54	188.54	336.03	3,246.24
16	1501001017911724	5,230.00	1,455.19	72.76	72.76	36.08	3,774.81	188.74	188.74	336.41	3,249.66
17	1300003004913133	3,944.50	1,330.05	66.50	66.50	33.54	2,614.45	130.72	130.72	226.17	2,257.56
18	2032000061781297	2,611.00	1,042.52	52.13	52.13	20.42	1,568.48	78.42	78.42	126.81	1,363.25
19	1110187297000158	2,401.50	801.29	40.06	40.06	11.23	1,600.21	80.01	80.01	129.82	1,390.38
20	1300003005984304	3,634.50	1,305.54	65.28	65.28	30.41	2,328.96	116.45	116.45	199.05	2,013.46
21	1700100100196894	2,391.70	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,096.63	54.83	54.83	81.98	959.82
22	1300003001811849	3,475.80	1,295.07	64.75	64.75	30.31	2,180.73	109.04	109.04	184.97	1,886.72
23	2011000104400655	2,087.10	1,097.34	54.87	54.87	22.5	989.76	49.49	49.49	71.83	868.44
24	2011000020409325	2,621.00	1,261.85	63.09	63.09	28.75	1,359.15	67.96	67.96	106.92	1,184.27
25	201100009355981	2,519.60	1,086.39	54.32	54.32	22.07	1,433.21	71.66	71.66	113.96	1,247.59
26	1304003005451477	3,280.70	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,985.63	99.28	99.28	166.44	1,719.91
27	1507001000553177	1,309.10	837.70	41.89	41.89	15.83	471.40	23.57	23.57	22.63	425.20
28	1507001003911220	2,473.30	1,042.52	52.13	52.13	20.42	1,430.78	71.54	71.54	113.72	1,245.52
29	1704003022544605	2,547.00	1,098.33	54.92	54.92	22.55	1,448.67	72.43	72.43	115.42	1,260.82
30	1300003006113314	2,598.80	910.99	45.55	45.55	15.43	1,687.81	84.39	84.39	138.14	1,465.28
31	1707003019879671	2,543.10	910.99	45.55	45.55	15.43	1,632.11	81.61	81.61	132.85	1,417.65
32	2027000158279475	2,550.60	910.99	45.55	45.55	15.43	1,639.61	81.98	81.98	133.56	1,424.07
33	1707003020891187	2,550.20	910.99	45.55	45.55	15.43	1,639.21	81.96	81.96	133.53	1,423.72
34	1405000055885656	2,438.50	910.99	45.55	45.55	15.43	1,527.51	76.38	76.38	122.91	1,328.22
35	1951780205021134	2,556.30	746.49	37.32	37.32	9.18	1,809.81	90.49	90.49	149.73	1,569.59
36	1305003005431057	2,481.20	746.49	37.32	37.32	9.18	1,734.71	86.74	86.74	142.6	1,505.37
37	1300003005430240	2,403.00	910.99	45.55	45.55	15.43	1,492.01	74.60	74.60	119.54	1,297.87
38	1300003005625986	2,369.90	910.99	45.55	45.55	15.43	1,458.91	72.95	72.95	116.4	1,269.56
39	1303003001879211	2,725.60	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,430.53	71.53	71.53	113.7	1,245.30
40	1506011000748536	2,378.20	691.69	34.58	34.58	7.08	1,686.51	84.33	84.33	138.02	1,464.16
41	1301003001967581	2,633.10	801.29	40.06	40.06	11.23	1,831.81	91.59	91.59	151.82	1,588.40
42	1911974974021189	2,559.60	636.84	31.84	31.84	4.98	1,922.76	96.14	96.14	160.46	1,666.16
43	1910533867321198	2,564.30	636.84	31.84	31.84	4.98	1,927.46	96.37	96.37	160.91	1,670.18
44	1301003001823536	2,609.50	691.69	34.58	34.58	7.08	1,917.81	95.89	95.89	159.99	1,661.93
45	1940423021321157	3,338.80	1,108.33	55.42	55.42	22.93	2,230.47	111.52	111.52	189.7	1,929.25
46	1170009021000186	2,619.50	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,324.43	66.22	66.22	103.62	1,154.59
47	1170054476000145	2,385.30	1,349.57	67.48	67.48	32.07	1,035.73	51.79	51.79	76.19	907.75
48	1303003010991197	2,324.90	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,029.83	51.49	51.49	75.63	902.71
49	1705018500202309	1,374.80	538.14	26.91	26.91	1.26	836.66	41.83	41.83	57.28	737.55
50	1300003007647951	2,384.70	1,283.62	64.18	64.18	29.58	1,101.08	55.05	55.05	82.4	963.63

51	1304003002216624	1,433.00	538.14	26.91	26.91	1.26	894.86	44.74	44.74	62.81	787.31
52	1300003007257429	2,329.20	746.49	37.32	37.32	9.18	1,582.71	79.14	79.14	128.16	1,375.41
53	1306003007802948	2,312.80	1,043.12	52.16	52.16	20.44	1,269.68	63.48	63.48	98.42	1,107.78
54	1303003007854508	2,313.30	746.49	37.32	37.32	9.18	1,566.81	78.34	78.34	126.65	1,361.82
55	1300003007900151	2,314.10	636.84	31.84	31.84	4.98	1,677.26	83.86	83.86	137.14	1,456.26
56	1401000013037076	2,428.10	746.49	37.32	37.32	9.18	1,681.61	84.08	84.08	137.55	1,459.98
57	1705018500133342	1,863.00	538.14	26.91	26.91	1.26	1,324.86	66.24	66.24	103.66	1,154.96
58	2021000016922548	2,306.50	856.14	42.81	42.81	13.33	1,450.36	72.52	72.52	115.58	1,262.26
59	2020000068641349	1,280.30	837.70	41.89	41.89	15.83	442.60	22.13	22.13	20.44	400.03
60	2033000164870422	2,521.80	1,295.07	64.75	64.75	30.31	1,226.73	61.34	61.34	94.34	1,071.05
61	1300003012217233	2,254.90	911.82	45.59	45.59	15.46	1,343.08	67.15	67.15	105.39	1,170.54
62	1903001633021198	630.00	278.06	13.90	13.90	4.16	351.94	17.60	17.60	13.55	320.79
63	2011000019604322	4,500.00	1,438.62	71.93	71.93	136.68	3,061.38	153.07	153.07	290.83	2,617.48
64	1300003004374880	3,200.00	1,038.54	51.93	51.93	98.64	2,161.46	108.07	108.07	205.34	1,848.05
65	2021000085025084	3,200.00	1,038.54	51.93	51.93	98.64	2,161.46	108.07	108.07	205.34	1,848.05
66	1406000060219857	3,200.00	1,038.54	51.93	51.93	98.64	2,161.46	108.07	108.07	205.34	1,848.05
67	2011000100375640	3,200.00	1,038.54	51.93	51.93	98.64	2,161.46	108.07	108.07	205.34	1,848.05
Gjithësejt:		215,478.88	71,383.69	3,569.18	3,569.18	1,889.35	144,095.19	7,204.76	7,204.76	12,169.29	124,721.14



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/37

Datë: 30.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë Nr. 08/04 të datës 28 shkurt 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 4. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 08/04 të datës 28 shkurt 2020, ashtu që afati i paraparë për paraqitjen e Raportit nga Grupi i Ekspertëve shtyhet deri më datë 10 korrik 2020.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/37

Datë: 30.05.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve, dhe Bashkimit Evropian e përfaqësuar nga Komisioni Evropian lidhur me marrëveshjen "Asistenca Makrofinanciare për Kosovën".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë